



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

| | |
|--------------------------------|---|
| Datë/a: | 10.03.2021 |
| Referenc-ë: | |
| Për/ Za/ To: | Shoqata "Autizmi" |
| Përmes/Preko/Through: | Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit |
| Nga/ Od/ From: | Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit |
| Tema/ Subjekat/Subject: | Pëlqim |

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Shoqata "Autizmi" me të cilën kërkohet që me datë 2 Prill 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi "Ibrahim Rugova" para Kuvendit nga ora 11:30 deri në 12:00 pasi që muaji Prill në mbar botën njihet si muaji i vetëdijesimit mbi Autizmin dhe përkrahjen e këtij komuniteti.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Ibrahim Rugova" me datën 2 Prill 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.